

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Projekti i ndërtimit të dy fushave në Luginën e Preshevës, Duka: Një detyrë morale për fëmijët shqiptarë
ADRESA	https://www.balkanweb.com/projekti-i-ndertimit-te-dy-fushave-ne-luginen-e-presheves-duka-nje-detyre-morale-per-femijet-shqiptare/
BURIMI	balkanweb.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:20:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	6 shtator 2026, 09:38:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 6 shtator 2026, 09:37:00 UTC → 6 shtator 2026, 09:39:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	23223844dafebb5df7dff1dc4517fc08f11f94be1021cefc82fd65b218ac59d
TEKSTI	7baa49be60c90f3319b9101b2634abfe7d29885ddc684e8a234b6a85edb4ab6f
PAMJA	174022f2382c3d0358519582d0d8ab433d295ccdbbe0a0a853490d97d1a0f620

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	84e0c2afc0700934256041f8fcac616dfcc5074c8c24bcfce2b3cf635aeafa60
E MËPARSHMJA	922c434020c51f9316dd852388c996f146927b1e86b70772fcd0652f6ad4e130
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/84e0c2afc0700934256041f8fcac616dfcc5074c8c24bcfce2b3cf635aeafa60>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

 balkanweb back button

- [Balkanweb TV](#)
- [Foto Galeri](#)
- [Emisione](#)
- [Moti](#)
- [Sondazh](#)
- [Shtypi](#)
- [Dossier](#)
- [Shëndeti](#)
- [Gatimi](#)
- [Horoskopi](#)
- [News24](#)
- [Kontakt](#)

 logo balkanweb e madhe

-
-
-

- [Fillimi](#)
- [Minutë pas minute](#)
- [Shqipëria](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Metropol](#)
- [Analiza](#)
- [Teknologji](#)
- [Shëndeti](#)
- [Horoskopi](#)
- [Emisione](#)

 logo balkanweb e madhe

 logo gazeta shqiptare

Kërko këtu

 Download on Apple Store  Get it on Google Play

- [Fillimi](#)
- [Minutë pas minute](#)
- [Shqipëria](#)
 - [-Kronikë](#)
 - [-Politikë](#)
 - [Aktualitet](#)
 - [-Ekonomi](#)
 - [-Sociale](#)
 - [-Kulturë](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni](#)
 - [-Greqi](#)
 - [-Magedoni](#)
 - [-Serbi](#)
- [Sport](#)
 - [-Bota](#)
 - [-Shqipëri](#)
 - [EURO 2024](#)
- [Bota](#)
 - [USA 2024](#)
 - [Lufta në Ukrainë](#)
- [Kulturë](#)
 - [-Art](#)
 - [-Libra](#)
 - [-Filma](#)
 - [-Muzikë](#)
- [Metropol](#)
 - [-Kuriozitete](#)
 - [-Life-Style](#)
 - [-Personazhe](#)
 - [-Show Bizz](#)
- [Analiza](#)
- [Teknologji](#)
 - [-Auto-Moto](#)
 - [-Pc-Mobile](#)
 - [-Shkence](#)
- [Shëndeti](#)
- [Horoskopi](#)
- [Emisione](#)

[Minute pas minute](#)

- [Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë](#)
- [VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal](#)
- [102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, vazhdojnë marshimin](#)
- ["Dorëheqje"/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve](#)
- ["Ju erdhi fundi"/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg](#)

- [Fillimi](#)
- [>](#)
- [Sport News](#)

Projekti i ndërtimit të dy fushave në Luginën e Preshevës, Duka: Një detyrë morale për fëmijët shqiptarë

06 Shtator, 2026 11:38

 Fshf

Madhësia e tekstit:

-
-
-
-
-
-
-

Federata Shqiptare e Futbollit vijon angazhimin për mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në Luginën e Preshevës, përmes projektit për ndërtimin e dy fushave moderne të futbollit, një në Komunën e Preshevës dhe një në Komunën e Bujanocit.

Kjo nismë vjen në vijim të bashkëpunimit që FSHF ka ndërtuar prej vitesh me komunitetin e futbollit në Luginë, duke e mbështetur atë me materiale sportive, uniforma dhe aktivitete të ndryshme për fëmijët. Një prej këtyre aktiviteteve ishte edhe turneu i organizuar vitin e kaluar, ku morën pjesë futbollistë të vegjël nga Lugina e Preshevës dhe diaspora e saj.

Gjatë kontakteve të vazhdueshme me komunitetin e futbollit dhe përfaqësuesit e dy komunave, u evidentua nevoja për përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe krijimin e kushteve më të përshtatshme për fëmijët dhe të rinjtë që duan të merren me futboll.

Pikërisht nga kjo nevojë lindi projekti për ndërtimin e dy fushave moderne, i cili tashmë është në fazën e përgatitjeve për realizim.

Në një prononcim për FSHF.org, Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, thekson se kjo nismë shkon përtej ndërtimit të dy fushave sportive. Sipas tij, projekti synon t'u krijojë fëmijëve shqiptarë në Luginën e Preshevës më shumë mundësi për t'u marrë me futboll dhe për të zhvilluar talentin e tyre.

"Federata e Futbollit ka marrë një iniciativë për të ndërtuar dy fusha në Luginën e Preshevës, një në Bujanoc dhe një në Komunën e Preshevës. Kjo iniciativë nuk lindi sot, pasi bashkëpunimi dhe mbështetja jonë për fëmijët në Luginën e Preshevës kanë filluar prej vitesh, duke i mbështetur me materiale sportive dhe uniforma. Vitin e fundit organizuam edhe një turne me futbollistë të vegjël nga Lugina dhe nga diaspora e Luginës.

Gjatë diskutimeve me komunitetin e futbollit dhe komunat e Preshevës dhe Bujanocit, pamë se infrastruktura sportive ishte vërtet në nivele të padëshirueshme. Për këtë arsye, vendosëm në Komitetin Ekzekutiv që t'i mbështesim me ndërtimin e një fushe, por më vonë ky vendim u ndryshua dhe ne vendosëm ta zgjerojmë projektin", – shprehet Presidenti Duka.

Zgjerimi i projektit në dy fusha solli edhe nevojën për një mbështetje më të gjerë financiare. Për këtë arsye, FSHF u është drejtuar bizneseve dhe donatorëve për t'u bërë pjesë e kësaj nisme dhe për të kontribuar në realizimin e saj.

Presidenti Duka falënderon bizneset që i janë bashkuar tashmë projektit, mes tyre edhe familjen Türker, e cila është bërë donatori i parë, ndërsa vlerëson gjithashtu bashkëpunimin me komunat dhe mbështetjen e komunitetit në Luginën e Preshevës.

"Ta zgjerojmë projektin, por nga ana tjetër ky projekt kërkon edhe financa. Për këtë ne iu drejtuam edhe bizneseve që të na mbështesin në iniciativën tonë, sepse për buxhetin tonë është vërtet një gjë që na rëndon shumë. Disa nga bizneset na janë përgjigjur pozitivisht për ta mbështetur projektin dhe për ta finalizuar atë.

Unë dua t'i falënderoj ato biznese që na kanë mbështetur. Në të ardhmen do të zhvillojmë aktivitete, promovime apo edhe inaugurimin e fillimit dhe përfundimit të punimeve bashkë me to. Dua të falënderoj edhe komunat për bashkëpunimin dhe të gjithë ata që kanë mbështetur këtë projekt nga Lugina e Preshevës.

Kjo nuk është vërtet një detyrë institucionale e Federatës, sepse ne duhet të organizojmë dhe të mbështesim futbollin brenda kufijve shtetërorë shqiptarë. Por është një detyrë morale e jona për shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve tanë. Në fund të fundit, e kemi një obligim moral që t'i ndihmojmë ata për të qenë sa më shumë afër futbollit", – tha Presidenti Duka.

Projekti i FSHF-së synon kështu të krijojë kushte më të mira për zhvillimin e futbollit të moshave në Preshevë dhe Bujanoc, duke u dhënë fëmijëve dhe të rinjve më shumë hapësira për të ushtruar sportin dhe për të ndjekur ëndrrat e tyre përmes futbollit.

Për realizimin e projektit, FSHF do të financojë ndërtimin e bazamentit, vendosjen e tapetit sintetik sipas standardeve të FIFA-s dhe pajisjen e fushave me porta, ndërsa komunat do të mbulojnë ndërtimin e ambienteve të zhveshjeve dhe hapësirave mbështetëse.

Federata Shqiptare e Futbollit vijon ndërkohë ftesën e hapur për bizneset, donatorët dhe të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë nismë, e cila synon t'i japë një mundësi më shumë fëmijëve shqiptarë në Luginën e Preshevës për të luajtur, për t'u zhvilluar dhe për të qenë sa më pranë futbollit.

© **BalkanWeb**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa:

- [Duka](#)
- [fshf](#)
- [lugina e presheves](#)

Të ngjashme



[Aobissnet Superiore/ Drejtoria Teknike e FSHF perzgjeun informacionin une trajnerin me te mire te javes se trete](#)

07 Shtator, 2026



[Vllaznia tërhiqet nga kampionati? Presidenti Matija konfirmon vendimin drastik](#)

04 Shtator, 2026

loading...

Të Fundit nga Sport News

[“Ky do të jetë viti ynë”, Harry Kane premton Champions](#)

09 Shtator, 2026

[Champions/ Mbappe futet në “top5”, Haaland një “përbindësh”, shifra rekord](#)

09 Shtator, 2026

[Haaland “thyen” Porton, realizon “dopjetë”, Marseca: Nuk ishte e lehtë](#)

09 Shtator, 2026

[Gola dhe gafa, Mou kapet pas rezultatit, Chivu: Më jep besim, treguam karakter](#)

09 Shtator, 2026

[Flick vendos rekord historik për Barçën, por drejtuesit ia ndalojnë të flas për Real Madrid: Zero fjalë për Mourinho-n](#)

08 Shtator, 2026

[Seferi sfidon Rey Manaj, duel në distancë për “Këpucën e Artë” në Turqi \(VIDEO\)](#)

08 Shtator, 2026

Kategoria Video

[Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë](#)

09 Shtator, 2026

[VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal](#)

09 Shtator, 2026

[102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, vazhdojnë marshimin](#)

09 Shtator, 2026

[“Dorëheqje”/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve](#)

09 Shtator, 2026


[“Ju erdhi fundi”/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg](#)

09 Shtator, 2026

[LIVE- Vijon aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!](#)

09 Shtator, 2026

loading...

 Balkanweb app [Download on Apple Store](#) [Get it on Google Play](#)

Kerko ketu

Lajmet e fundit

-

[Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë](#)

09 Shtator, 2026

[VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atletico, një gol vendos Napoli-Arsenal](#)

09 Shtator, 2026

[102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, vazhdojnë marshimin](#)

09 Shtator, 2026

[“Dorëheqje”/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve](#)

09 Shtator, 2026

[“Ju erdhi fundi”/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg](#)

09 Shtator, 2026

[LIVE- Vijon aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!](#)

09 Shtator, 2026

Na ndiqni në rrjetet sociale

@balkanweb

-
-
-

 scroll to top

 logo balkanweb

Faqet zyrtare

- [News24](#)
- [Gazeta Shqiptare](#)
- [Radio RASH](#)

Kontakt

- [Focus Media News shpk](#)
- [NUIS/NIPT K21909002K](#)
- [Privacy Policy](#)
- [Contact](#)

- [Email: \[email protected\]](#)

Emisione news24

- [Autoktonët](#)
- [Emisioni Vila 24](#)
- [Fit Station](#)
- [Kjo Javë](#)
- [Koha për t'u zgjuar](#)
- [Me zemër të hapur](#)
- [Në shënjestër](#)
- [News24 Fundjavë](#)
- [Opionencë](#)
- [Podcast](#)
- [Sport News](#)
- [Studio 24](#)
- [Fak Fak](#)
- [Vetting](#)

Kategori

- [Fillimi](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.